

VENDIM
Nr. 467, datë 17.7.2024

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKIA TIRANË TË OBJEKTIT “GODINË
E SHËRBIMEVE KOMUNITARE, VAQARR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi te Bashkia Tiranë të objektit “Godinë e shërbimeve komunitare, Vaqarr”, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Të dhënat e përmbledhura për objektin / BASHKIA TIRANE

Nr.	Qarku	Bashkia	Njesia Administrative	Niveli	Emertimi i objektit	Tipologjia e Ndërhyrjes	Financimi i Ndertimit	Sipërfaqe Totale Ndertimit (m ²)	Vlera e Studim Projektimit	Vlera e zbatimi të ndërtimit	Vlera e Mbikqyrësit	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
1	Tirane	Tirane	Vaqarr	Qëndër Komunitare	Godina e Shërbimeve Komunitare Vaqarr	Ndërtim i ri	Rindërtim	1,580	950,000	93,941,319	799,900	40,000	95,731,219
TOTAL								1,580		93,941,319	799,900	40,000	95,731,219